

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 147 (64-2022-427), datë 10.3.2022, vendosi caktimin e shtetases Vioselda Vreto, si kujdestare ligjore të fëmijës së mitur Vilson Malkaj, i datëlindjes 28.6.2008.

Personat e tretë, Gentian Malkaj dhe Klementina Malkaj kanë të drejtë të takojnë fëmijën e tyre, Vilson Malkaj, çdo ditë të muajit, por vetëm në prani të familjarëve të tjerë të fëmijës së mitur, duke vlerësuar se këto takime janë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.